



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-te, Prishtinë, Kosovë
Tel+ 383 38 212 309 e-mail oshp@rks-gov.net

PSh. Nr. 3021/23

Paneli Shqyrtues i Prokurimit, i emëruar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) në bazë të nenit 105 dhe 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 04/L-042 (i amendamentuar), në përbërje nga Isa Hasani- Kryetar, Vjosa Mexhuani Gradinaj-Anëtare dhe Vedat Poterqoi-Anëtar, pas shqyrtimit të kërkesës për diskualifikim të ushtruar nga Ndërmarrja Publike Banesore SH.A në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) (Nr. Protokolli 3021/23), ushtruar ndaj Operatorit Ekonomik (OE) "Infra Group" SHPK, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material ndërtimor për renovimin e QMF - Prishtinë, me nr. të prokurimit: 1909466981031194-23-12472-1-3-6, duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës dhe nenit 32 të Rregullores së Punës së OSHP, me 28.02.2024, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet, si e bazuar kërkesa e Ndërmarrja Publike Banesore SH.A në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, e datës 18.12.2023, kurse OE "Infra Group" SHPK diskualifikohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për periudhën kohore në kohëzgjatje 3/tre muajsh, duke filluar nga data 28.02.2024 deri me datën 27.05.2024, për shkak të prezantimit të dokumenteve të falsifikuara, vepër kjo e parashikuar me nenin 99, paragrafi 2 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

2. Urdhërohet AK (me shënime si më sipër) që ta konfiskoj shumën e mjeteve të deponuara nga OE "Infra Group" SHPK në emër të sigurimit të ofertës, siç parashihet me nenin 57, paragrafi 1.1, të LPP.

3. OSHP ka të drejtë që ta revokoj masën e shqiptuar, nga dita kur dhe nëse OSHP njoftohet me aktin e organeve kompetente, sipas të cilit vërtetohet se vepra e kualifikuar sipas paragrafit 1, të dispozitivit të këtij vendimi, nuk është kryer.

Arsyetim

Me 18. 12. 2023, nga Ndërmarrja Publike Banesore SH.A në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka dorëzuar në OSHP, kërkesë për aplikim të masave sipas nenit 99 të LPP, ndaj OE “Infra Group” SHPK me arsyetimin se i njëjti ka ofruar dëshmitë e kërkuara në këtë aktivitet të prokurimit, precizuar si në hyrje të këtij vendimi.

Nga shkresat e kësaj lënde kuptohet se OE “Infra Group” SHPK ka aplikuar në aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material ndërtimor për renovimin e QMF - Prishtinë, me nr. të prokurimit: 1909466981031194-23-12472-1-3-6.

AK-NPB me datën 08.11.2023 ka publikuar njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e sipërcituar. Kjo procedurë ka qenë Koutim i Çmimit me vlerë të vogël, ndërsa afati i vlefshmërisë së tenderit ka qenë 30 dite. Siguria e tenderit nuk është kërkuar. Gjatë fazës tenderuese nuk kemi pranuar kërkesa për sqarim të tenderit, kurse hapja e ofertave është bërë me datë 15.11.2023

Janë pranuar gjithsej gjashtë oferta. Në mesin e ofertave të pranura është edhe oferta e Operatorit Ekonomik “Infra.Group” SH.P.K., ku sipas procesverbalit të hapjes së ofertave ka qenë oferta me çmimin më të lirë. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit të ofertave, komisioni ka konstatuar se i OE në fjalë ka qenë i përgjegjshëm me ofertën e tij dhe si rezultat, në mënyrë unanime kane rekomanduar që i njëjti të shpërblehet me Kontratë pasi që edhe kishte ofertuar me ofertën me çmimin më të ulët. Pas pranimit të Raportit të Vlerësimit të tenderëve, nga OE “Infra Group” SH.P.K., i rekomanduar për shpërblim me Kontrate është kërkuar që konform Kërkesave të Përshtatshmërisë në Dosjen e Tenderit, pika b. dhe c., që f i dorëzoj dëshmitë/dokumentet (Vërtetimin e ATK-së se nuk ka borxhe dhe Vërtetimin e lëshuar nga Gjykata apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit për situatën referuar Nenit 65 të LPP-së), në mënyrë që të krijoheshin kushtet për të vazhduar tutje me përmbylljen e këtij procesi.

Bazuar në dispozitat ligjore të përcaktuara sipas LPP-së (Neni 65 dhe 66) dhe Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, respektivisht nenet 25.9, 32.17 dhe 32.18, janë të specifikuara veprimet dhe masat që duhet ndërmarrë në rastet kur OE ofertues nuk ju përgjigjet kërkesave të AK-së konform dispozitave ligjore apo edhe tërhiqen nga tenderimi.

Mbi këtë bazë, AK duke pas parasysh aktivitetin e prokurimit në fjalë ishte “Kuotim-i- Çmimit me vlerë të vogël dhe nuk ishte kërkuar “Siguria e Tenderit dhe duke u bazuar në Dispozitat ligjore të LPP-së dhe të Rregullores së Prokurimit Publik, që ndalojnë tërheqjen pas datës së fundit për dorëzim të ofertave, konsideron se OE ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e parapara ligjore dhe në kundërshtim me Kërkesat e Përshtatshmërisë në DT, për përmbushjen e të cilave është deklaruar përmes nënshkrimit të Deklaratës nën Betim, të cilën e ka dorëzuar me ofertë, e që në fakt nuk i ka paraqitur dëshmitë mbi Kërkesat e Përshtatshmërisë sipas kërkesës së AK-së. Mos përmbushja e detyrimeve konform “Deklaratës së dhënë nën Betim” nga ana e OE “Infra Group” SH.P.K, Ndërmarrjes Publike Banesore i krijon shpenzime shtesë për shkak se për të përmbyllur në tërësi këtë proces, ne duhet të kalojmë tek operatori i dytë me radhë i cili ka ofertuar me çmim më të lartë me një diferencë prej 1,174.00 €. AK përmes Platformës së e-prokurimit me datë 30.11.2023 ka kërkuar nga OE i rekomanduar për kontratë që ne afat prej 5 ditëve të sjell dëshmitë e dokumentuara lidhur me kërkesat e nenit 65 të LPP-së (vërtetimi nga ATK dhe nga Gjykata) dhe OE nuk ka kthyer asnjë përgjigjeje lidhur me kërkesën e AK-së.

Pas pranimit të kërkesës së autoritetit kontraktues OSHP ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar kërkesën e dorëzuar të AK-së dhe dokumentacionin e lëndës, i cili me datën 10. 01. 2024 ka dorëzuar raportin me rekomandimin që ndaj OE të aplikohet neni 99 par 2 i LPP-së.

Paneli shqyrtues pas analizimit të akteve dhe veprimeve të palëve dhe pretendimeve reciproke të tyre, konstatoj se në lënda në rastin konkret përmban dokumente dhe shkresa të mjaftueshme, mbi bazën e te cilave Paneli ka të drejtë të vendos në aspektin meritior pa prezencën e palëve, sikurse parashihet kjo me nenit 24 paragrafi 1, të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli shqyrtues pas analizimit të shkresave dhe fakteve të lëndës, ka konstatuar se është jo kontestues fakti se operatori ekonomik (me shënime si më sipër) ka marrë pjesë në këtë aktivitet të prokurimit, por njëherësh konsiderohet se është jo kontestues edhe fakti se i njëjti është tërhequr nga rrjedha e mëtejme dhe përmbushja e detyrimeve të cilat parashihen si të tilla në kuptim të LPP. Sipas Panelit tërheqja e OE si në këtë rast duke mos i ofruar dokumentet e kërkuara, konsiderohet si një qasje jo serioze e cila i krijon dëme në ushtrimin e rregullt të detyrave të AK. Plotësimi i dokumenteve të kërkuara nga AK, është e domosdoshme së paku në kuptim të nenit 64 (Dëshmitë e kërkesave) nenit 65 (Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve) dhe nenit 69 (Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale) të LPP.

Bazuar në pohimet e AK, në veprimet e OE dhe natyrën e aktivitetit të prokurimit në rastin konkret, Paneli Shqyrtues konsideron se është fakt jo kontestues se OE janë tërhequr nga plotësimi i detyrimeve të tij, OE ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e parapara ligjore dhe në kundërshtim me Kërkesat e Përshtatshmërisë në DT, të cilat shprehimisht parashihet si të tilla në kuptim të dispozitave të cituara si më sipër të LPP. Prandaj objektivisht lind detyrimi i OSHP-së që ta zbatoj dispozitën e cituar si më sipër të LPP sipas së cilës kërkohet që operatorët ekonomik në rastin konkret të diskualifikohen nga pjesëmarrja në prokurim publik dhe (sipas gjykimit të pavarur të këtij Paneli) të njëjtëve ju ndalohet e drejta për të marrë pjesë në aktivitetet e prokurimit publik në periudhën kohore në kohëzgjatje 6 muaj, duke filluar nga data 06.02.2024 deri me datën 06.08.2024. Për panelin shqyrtues është jo kontestues fakti se shumë OE të cilët po marrin pjesë në aktivitete të prokurimit sidomos në procedurat me vlerë të vogël po tërhiqen nga aktiviteti i prokurimit pa ndonjë justifikim pasi që zakonisht për procedura të tilla nuk po kërkohet sigurim i ofertës, dhe kjo po ju shkakton vonesa autoriteteve kontraktues dhe njëkohësisht po detyrohen të nënshkruajnë kontrata me OE me çmim me te larta për shkak se OE po tërhiqen nga aktiviteti prokurimit pa dhënë ndonjë arsytim.

Megjithatë, Paneli Shqyrtues sqaron se masa e diskualifikimit, e shqiptuar dhe shpjeguar si më sipër, mund të revokohet nga momenti kur dhe/ose nëse OSHP njoftohet nga autoritetet kompetente se vepra e cituar dhe e komunikuar sipas paragrafit 1, të dispozitivit të këtij vendimi, nuk është kryer.

Paneli Shqyrtues, bazuar në kompetencat e parapara me nenin 105, të LPP, i komunikoi AK po ashtu Urdhrin për konfiskim të sigurimit të ofertës ndaj OE “Infra Group” sipas pikës 2, të dispozitivit të këtij vendimi, nëse AK nuk e ka aplikuar masën e sigurimit të cituar si më sipër, në zbatim të nenit 57, paragrafi 1.1, të LPP, sipas të cilit “Autoriteti kontraktues vendos, duke u bazuar në fakte të verifikuara se tenderuesi në fjalë i ka dhënë autoritetit kontraktues informacione përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese”.

Duke ju referuar të lartcekurave si dhe duke u bazuar në dispozitën e nenit 99.2 të LPP, Paneli shqyrtues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit
Isa Hasan



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, kurse pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet me kërkesëpadi Gjykatës Kompetente për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – KK Prishtinë

1x1 OE "Infra Group"

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së